



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 11 janar 2017

Numri i lëndës: 2013-21

Thomas Rüsche

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 11 janar 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, vendosi si në vijim:

PROCEDURA

1. Ankesa është regjistruar me 12 gusht 2013.
2. Me 7 prill 2014, Paneli ka vendosur që ta njoftojë shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it rreth kësaj ankese, duke e ftuar atë që t'i paraqesë vërejtjet me shkrim. Po ashtu, u vendos që të shqyrtohen bazat e kësaj kërkesë në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e saj (në pajtim me Rregullën 30 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Punës së Panelit, në tekstin e mëtejshëm RRP).
3. Vërejtjet e ShM-së janë pranuar me 3 dhjetor 2014, pastaj i janë komunikuar parashtruesit të ankesës për vërejtjet e tij shtesë.
4. Ankuesi e ka parashtruar përgjigjen e tij me 20 dhjetor 2014. SHM i ka parashtruar vërejtjet shtesë të tij me 23 mars 2015.

I. FAKTET

1. HISTORIKU I LËNDËS

1. Me 28 prill 2006, ankuesi e ka nënshkruar një kontratë me I.F. dhe M.L. për themelimin e kompanisë me përgjegjësi të kufizuar MTI Stone and Building (MTI), (në tekstin e mëtejme "kompania"). Marrëveshja ishte arritur që kompania të jenë në pronësi të barabartë të palëve (me nga 33% secili). MTI ishte regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës.
2. Kjo kompani u pajis me licencë për eksploatimin e burimeve të andesitit. Përgjatë një periudhe kohore ankuesi kishte investuar mjete të konsiderueshme për kërkimin dhe gjetjen e këtij burimi në Kosovë. Si rezultat i kësaj, ai i kishte zvogëluar në minimum aktivitetet punuese të tij në Gjermani.
3. Me 4 prill 2007, ishte nënshkruar një Shtojcë për nenet lidhur me bashkimin e kompanisë me anë të së cilës u bë rindarja e aksioneve të kompanisë, duke ia dhënë ankuesit dhe M.L. nga 47.5% të aksioneve secilit kurse I.F. 5% të aksioneve.
4. Më pas ankuesi i ka zbuluar veprimtaritë e pohuara kriminale të partnerëve të tij të biznesit. Si rezultat i kësaj, ata janë përpjekur që ta largojnë atë nga kompania nëpërmjet falsifikimit të neneve lidhur me bashkimin e kompanisë si dhe duke drejtuar kërcënime ndaj tij. Me 5 gusht 2009, ishte hartuar një kontratë "për dhënien e aksioneve pa pagesë", e cila ishte nënshkruar vetëm nga M.L. dhe I.F. Aty thuhej se ai ia barte aksionet e tij I.F. dhe M.L. pa kurrfarë pagese. Si rezultat i kësaj, M.L. dhe I.F. secili nga ta, morën nga 50% të aksioneve të kompanisë. M.L. ishte emëruar drejtor i saj. Kësisoj ankuesi ishte privuar nga aksionet e tij.
5. Me 14 gusht 2009, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës i regjistroj këto ndryshime në nenin lidhur me bashkimin e kompanisë.
6. Ankuesi pretendon se nga një datë e pacaktuar atij nuk i ishte lejuar që t'i ushtrojë funksionet e tij si drejtor ekzekutiv i kompanisë. Gjithashtu, atij nuk i ishte dhënë qasje në dokumentet dhe pasqyrat financiare të saj. Po ashtu atij iu ishte refuzuar qasja në mjediset e kompanisë.
7. Me 3 nëntor 2010, ankuesi ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve për ta kthyer atë si aksionar të kompanisë dhe për ta shfuqizuar vendimin e saj të mëparshëm (shih par. 5 më sipër) pasi që ishte bazuar në dokumente të kundërligjshme që ishin parashtruar nga M.L. dhe I.F. Pas kësaj kërkesë, ushtruesi i kryeshefit ekzekutiv të kësaj Agjencie, duke vepruar në bazë të nenit 16 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, e kishte kthyer kompaninë në statusin juridik të mëparshëm të saj, ku ankuesi ishte kthyer si aksionar që kishte në posedim të përqindjes së mëparshme të aksioneve.
8. Me 16 qershor 2015 Gjykata Ekonomike i akordoj ankuesit shumën prej 874,000 euro si kompensim për dëmet e shkaktuara, duke e përfshirë kamatën ligjore. E drejta e të pandehurve M.L. dhe I.F. mbi pronësinë e aksioneve të kompanisë ishte ndërprerë dhe ata u përjashtuan nga ajo.

2. Përfshirja e EULEX-it

A. Ankesa e parë - Rasti nr. PPS 26/2010

9. Me 17 shtator 2009, ankuesi i ka dërguar letër shefit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) në të cilën ka kërkuar që të ndërmerren masat e duhura kundër keqpërdorimeve të pretenduara të raportuara të aksionarëve të tij dhe që atij t'i ofrohej mbrojtje.
10. Me 10 shkurt 2010 prokurori special i EULEX-it u takua me ankuesin. Aty ishte rekomanduar që ai të ofronte sqarime më të hollësishme lidhur me situatën për të cilën ai ankohej.
11. Me 11 mars 2010 përfaqësuesi i ankuesit ka parashtruar kallëzimin penal plotësues në PSRK kundër I.F. dhe M.L. dhe kundër ushtruesit të detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve, legalizimit të përmbajtjes së pavërtetë, mashtrimit, keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe nënshkrimit të kontratave të dëmshme. Për këtë u dorëzuan provat dhe dokumentet përkatëse.
12. Me 25 maj 2010, PSRK e ka transferuar këtë lëndë te prokurori i EULEX-it N.A. në Prokurorinë e Qarkut në Mitrovicë.
13. Me 10 nëntor 2010, kryeprokurori i EULEX-it ia ka caktuar lëndën prokurorit të EULEX-it P.K. pas kërkesës së tij që ta bëjë këtë.
14. Me 25 nëntor 2010, prokurori i EULEX-it ka kërkuar që EULEX-i ta caktojë një gjykatës të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për këtë lëndë. Gjatë seancës më 2 dhjetor 2010 prokurori i EULEX-it ka deklaruar se arsyeja për kërkesën e tij ishte bazuar në "interesin e fuqishëm të shoqërisë në sigurinë e biznesit dhe ndërmarrësisë në këtë fushë, ku dëmet e vlerësuara në këtë rast ishin rreth pesë milion euro".
15. Me 17 janar 2011 gjykatësi kryesues në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë ia caktoi këtë lëndë (PPS. Nr. 26/2010) gjyqtarëve të EULEX-it.
16. Aktvendimi për fillimin e hetimeve (AFH) ishte nxjerrë me 23 shkurt 2011 ndaj M.L. dhe I.M. lidhur me pretendimet se kishin kryer veprën penale të mashtrimit në gusht 2009 (Rasti Nr. PPS. 26/2010).
17. Me 25 shkurt 2011 prokurori i EULEX-it ka parashtruar një kërkesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë për një urdhër për bastisjen e shtëpive. Kjo kërkesë u miratua me 1 mars 2011. Me 4 mars 2011 janë bërë bastisjet nga ana e autoriteteve hetimore. Një numër i sendeve janë konfiskuar duke përfshirë një kompjuter, një pushkë AK 47 dhe një numër dokumentesh. Një numër i raporteve përkatëse ishin parashtruar tek prokurori nga policia. Njësisia për Hetimin e Krimeve Ekonomike ishte autorizuar nga prokurori i EULEX-it që ta kryente kontrollimin e kompjuterëve të konfiskuar. Të dy të dyshuarit ishin intervistuar.
18. Me 30 mars 2011 prokurori i EULEX-it i ka dërguar një autorizimi hetuesve të Task Forcës në Mitrovicë për të kryer një numër hapash hetimorë dhe t'i raportojnë atij jo më vonë se me 30 qershor 2011, dhe sipas nevojës duke paraqitur raporte periodike. Panelit nuk i është ofruar asnjë dëshmi nëse kjo kërkesë është përmbushur.
19. Me 4 gusht 2011 prokurori i EULEX-it P.K. ka nxjerrë një Aktvendimin për pezullimin e hetimeve në rastin PPS Nr. 26/10. Në bazueshmërinë për këtë Aktvendim, *mes tjerash*, shkruan si në vijim:

“Përkundër përpjekjeve të policisë së EULEX-it, i pandehuri M.L. nuk është mundur të gjendej as në Kosovë e as në Gjermani nga Zyra e Prokurorisë Publike në Siegel, Gjermani, ku ai ballafaqohet me një procedurë tjetër penale. Prandaj, prokurori publik supozon se ky i pandehur është duke u fshehur nga hetimet dhe është larguar në ndonjë vend të panjohur. Për më shumë, për shkak të veprave penale të kohëve të fundit në veri të Kosovës, policia e EULEX-it i ka drejtuar të gjitha kapacitetet e veta në zgjidhjen e rasteve më të rënda të reja. Në këto rrethana, për momentin nuk ka mundësi të sigurohen prova të tjera.

Prokurori publik ndërkombëtar konsideron se të gjitha provat që kanë mundur të mblidhen lidhur me veprat penale dhe përgjegjësinë penale të të dyshuarve, të cilët nuk kanë qenë në dispozicion të prokurorit, janë mbledhur dhe se tashmë janë shtrë të gjitha mundësitë hetimore. Kjo do të thotë se është përmbushur kriteri i përcaktuar në nenin 223 paragrafi (2) i KPPK”.

20. Me 4 prill 2012 prokurori i EULEX-it S.G. ia ka dërguar një Autorizim Drejtorisë së Policisë të Kosovës për Krime Ekonomike dhe Korrupsion duke e urdhëruar atë që t'i vërtetojë një numër faktesh në lidhje me këtë rast.
21. Me 5 qershor 2012 Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit e Policisë së Kosovës i ka paraqitur një raport prokurorit të EULEX-it ku, mes tjerash, e informon atë lidhur me kontratën të cilën e kishin nënshkruar aksionarët e ankuesit me 5 gusht 2009 (shih par. 4 më sipër) dhe për regjistrimin e asaj kontrate nga Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (shih par. 5 më sipër).
23. Me 5 qershor 2012 zyra e Administratës Tatimore në Mitrovicë e ka paraqitur një raport prokurorit të EULEX-it S.G. për një inspektim tatimor të kësaj kompanie. Me 3 korrik 2012 ky prokuror e ka intervistuar F.I., i punësuar i kësaj kompanie, në cilësinë e dëshmitarit.
24. Si rezultat i një letre të kryeprokurorit të EULEX-it të datës 17 nëntor 2014 për prokurorin e EULEX-it N.A., Prokuroria Themelore në Mitrovicë me 16 dhjetor 2014 ky i fundit ka nxjerrë Aktvendim për rifillimin e hetimeve. Ky hetim aktualisht është në vijim e sipër. Nuk është nxjerrë ndonjë vendim formal për mbylljen e tij.

B. Rasti PP 360/2012

25. Me shtator 2012 ankuesi e ka informuar Njësinë për Hetime Financiare (NJHF) të Policisë Ekzekutive të EULEX-it se M.L., i cili ishte pronar i një kompanie tjetër, S-B, i kishte marrë me qira dy makina gurëthyese nga një kompani në Gjermani, Apex-Lieben Crush & Screentec dhe se më pas ai i kishte importuar këto makina në Kosovë dhe ia kishte shitur kësaj kompanie.
26. NJHF e EULEX-it e kishte filluar një hetim dhe me 9 tetor 2012 kishte parashtruar një raport me anë të cilit vërtetohej se makinat ishin pronë e kompanisë gjermane Apex-Lieben Crush & Screentec, e cila e kishte bërë të qartë se dëshironte t'ju ktheheshin makinat e tyre.
27. Me 10 tetor 2012 ishte nxjerrë një Aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj I.F. dhe M.L. (rasti nr. PP 360/2012). Ky rast është trajtuar nga një ekip i përzier në kuadër të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Fillimisht rasti i

- ishite caktuar prokurorit të EULEX-it P.P. (shtator-nëntor 2012) dhe prokurorit M.G. prej shtatorit 2013 e më tutje.
28. Me 18 shtator 2012 ankuesi dhe përfaqësuesi i tij ishin takuar me prokurorin e EULEX-it P.P. dhe me këshilltarin ligjor. Prokurori ka sqaruar veprimet hetimore që do të ndërmerreshin.
 29. Ndërmjet datës së AFH, d.m.th. 10 tetor 2012 dhe 30 tetor 2012, prokuroria ka paraqitur Kërkesë për Publikimin e të Dhënave Financiare, një Kërkesë për Bastisje të një shtëpie dhe objekteve të tjera, një Urdhër për Publikimin e të Dhënave Tatimore, tetë Autorizime, një Kërkesë për Urdhër arrest për dy të pandehurit dhe një Kërkesë për Fletërreshtim ndërkombëtar kundër dy të pandehurve. Në të njëjtën periudhë, NJHF e EULEX-it dhe Policia e Kosovës kanë paraqitur një numër të raporteve lidhur me veprimet e ndërmarra.
 30. Me 17 tetor 2012 bastisjet janë zhvilluar në Mitrovicë në një operacion të përbashkët të Policisë së Kosovës/Policisë së EULEX-it gjatë të cilit u konfiskuan një numër i dokumenteve, pajisjeve dhe sendeve të tjera. Me 22 tetor 2012, prokurori i EULEX-it e ka udhëzuar kreun e Agjencisë për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar (AMPSK) që ta mundësojë ruajtjen e sendeve të konfiskuara.
 31. Me 8 nëntor 2012, ankuesi u intervistua përsëri nga policia e EULEX-it.
 32. Me 15 nëntor 2012, me kërkesë të prokurorit P.P., gjyqtari i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë e ka lëshuar një Fletërreshtim ndërkombëtar për I.F. dhe M.L.
 33. Me 28 nëntor 2012 prokurori i EULEX-it nxori Aktvendim për Pezullimin e Hetimeve në pajtim me nenin 223 të KPPK që atëherë ishte i aplikueshëm (tani neni 157 i KPP-së 2013). Arsyet mbi të cilat u bazua ishin se të dy të pandehurit besojnë se ishin jashtë Kosovës pasi që të dy ishin shtetas gjermanë dhe banonin në Gjermani. Të pandehurit kishin bërë me dije se nuk ishin të gatshëm që t'i përgjigjeshin ndonjë kërkesë për t'u intervistuar. Si shtetas të huaj, ata me siguri do të vazhdonin të refuzonin që t'i nënshtroheshin juridiksionit të Kosovës. Të gjitha përpjekjet e policisë për t'i ftuar të pandehurit që të intervistohen, deri këtu ishin të pasuksesshme.
 34. Me 12 shkurt 2013 prokurori i EULEX-it M.G. ka udhëzuar NJHF të EULEX-it/Njësinë e PK kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, Mitrovicë, që ta mundësojë lirin dhe transferimin e një prej sendeve të konfiskuara që ruheshin në ambientet e AMPSK në Mitrovicë tek ankuesi duke qenë se ai ishte pronari i ligjshëm i kamionit.
 35. Me 13 shkurt 2013 prokurori i EULEX-it M.G. ka rifilluar hetimet ndaj I.F. dhe me 14 shkurt 2013 kundër M.L. Më 14 shkurt 2013, me kërkesë të prokurorit të EULEX-it, urdhër arrestet ndaj dy të pandehurve u tërhoqën nga gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
 36. Me 15 shkurt 2013 M.L. dhe I.F. ishin intervistuar në Bazën Logjistike të EULEX-it në Mitrovicë nga një zyrtar policor i EULEX-it dhe i Policisë së Kosovës në prani të avokatëve mbrojtës të tyre. Ata u informuan lidhur me kualifikimin juridik të veprave penale për të cilat ata po merreshin në pyetje, pra për keqpërdorimin e autorizimeve ekonomike, mashtrim dhe përvetësim. Me 26 shkurt 2013, M.L. ishte intervistuar përsëri.
 37. Me 1 mars 2013 prokurori i EULEX-it M.G. ka nxjerrë Aktvendimin për Pezullimin e Hetimeve. Aty u theksua se për shkak të natyrës ndërnacionale të hetimeve ndaj dy të pandehurve të cilët nuk ishin

banorë të përhershëm të Kosovës, vazhdimi i hetimeve përbënte rrethana të atilla që e pengonin ndjekjen e suksesshme penale të tyre.

38. Me 16 maj 2012 prokurori i EULEX-it M.G. ka nxjerrë Aktvendimin për Ndërprerjen e Hetimeve. Duke pasë parasysh provat, ai erdhi në përfundim se nuk ekzistonte më dyshimi i bazuar bindës se këto vepra penale ishin kryer nga të pandehurit. Ishte vlerësuar se nuk kishte të ngjarë që hetimet e mëtejme do të siguronin bazë të mjaftueshme për t'i vazhduar hetimet.
39. Me 3 qershor 2013 ankuesi i ka shkruar prokurorit të EULEX-it M.G., duke kërkuar nga ai që ta ndryshojë vendimin e tij për ndërprerjen e hetimeve. Ai i kishte ofruar prokurorit materiale të reja në lidhje me rastin. Prokurori i EULEX-it është përgjigjur përmes një letre të datës 24 qershor 2013, ku ai e ka informuar ankuesin se nuk ishte i gatshëm që ta rishqyrtojë vendimin e tij apo t'i analizojë materialet e reja që ishin ofruar. Ai më tej kishte theksuar se ky material duhej t'i dërgohej autoriteteve vendore meqë kjo çështje nuk bënte më pjesë në kuadër të prioriteteve të EULEX-it. Po ashtu ai kishte kërkuar nga ankuesi që mos ta kontaktonte më as atë e as Policinë e EULEX-it.

III. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

40. Ligji nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (në fuqi deri me 30 maj 2014)

Dispozitat përkatëse të këtij ligji parashohin:

Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it për procedurat penale (...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtimin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të parapara sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja:

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paafësisë së prokurorëve publik të Kosovës

12.1. Në secilën fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një vepre penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një vepre penale, kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktojë: a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyre prokuroriale, b) apo cilitdo prokuror të EULEX-it që do të merr përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse. (...)

41. Ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës

Neni 3 Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (në fuqi prej datës 31 maj 2014)

.....

9. Neni 7 i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

Neni 7 Autoriteti dhe kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it

7.1. Prokurorët e EULEX-it do të kenë autoritet dhe përgjegjësi t'i kryejnë funksionet, përfshirë autoritetin për kryerjen e hetimeve penale ashtu siç përcaktohet në nenin 2.1 të këtij ligji, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.

7.2. Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të PSRK-së në pajtim me ligjin mbi PSRK-në.

7.3. Prokurorët e EULEX-it janë të integruar në sistemin prokurorial të Kosovës dhe do të ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

7.4. Rastet e udhëhequra nga prokurorët e EULEX-it të përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji do të vazhdojnë të menaxhohen në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (2008) dhe të Ligjit për PSRK-në (2008).

7.5. EULEX-i KOSOVË do të caktoj prokurorë që të ndihmojnë lidhur me zbatimin, sipas marrëveshjes, të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga BE-ja.

7.6. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, prokurorët e EULEX-it do të konsultohen dhe bashkërendojnë ngushtë aktivitetet e tyre me kryeprokurorin përgjegjës të zyrës, aty ku janë të caktuar.(...)

II. ANKESAT

42. Ankuesi pohon se misioni EULEX-i Kosovë nuk e ka mbrojtur të drejtën e tij për t'i gëzuar në mënyrë paqësore pasuritë e tij e garantuar në bazë të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Po ashtu, ai ankohet se EULEX-i i ka shkelur të drejtat e tij për zgjidhje efektive e garantuar me Nenin 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa").

II. LIGJI

SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 DHE NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

43. Ankuesi ankohet sipas Nenit 13 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës (shih par. 42 më sipër). Dispozitat përkatëse, për aq sa janë përkatëse, parashohin si vijon:

Neni 1 – Protokollit 1, Mbrojtja e pronës

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare [...]."

Neni 13 - E drejta për zgjidhje efektive

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".

44. Si çështje e të drejtës materiale, Paneli është i autorizuar t'i zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut të përmendura në Konceptin për Llogaridhënien e EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e këtij Paneli janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat i përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhen garantuar nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.

Parashtresat nga Palët

45. Në parashtresën e tij të datës 3 dhjetor 2014, SHM-ja ka pohuar se shkresat e lëndës nr. PPS 26/2010 nuk i kanë pasqyruar në mënyrë të duhur veprimet hetimore të ndërmarra nga EULEX-i ndërmjet datës 17 shtator 2009, kur ankuesi ka kontaktuar së pari shefin e PSRK-së, dhe datës 10 shkurt 2010 (shih par. 9). Ankuesi ka kërkuar një periudhë shtesë prej tri javësh për t'i ndryshuar parashtresat fillestare të tij.
46. SHM-ja pohon se një numër i masave hetimore ishin ndërmarrë nga prokurori i EULEX-it në pajtim me Aktvendimin për Fillimin e Hetimeve të datës 23 shkurt 2011. Këto masa përfshijnë bastisjen e shtëpisë dhe

- dërgimin e Autorizimeve tek Njësia për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Hetimore të Task Forcës. Pas përfundimit të këtyre hapave, prokurori i EULEX-it i ka pezulluar hetimet me 4 gusht 2011 pasi që i pandehuri M.L. nuk mund të gjendej.
47. Është pohuar se përfaqësuesit të ankuesit i ishte dhënë qasja në të gjitha shkresat e lëndës. Ai i ka shqyrtuar këto shkresa në Bazën Logjistike të EULEX-it, Mitrovicë. Ai nuk kishte kërkuar kopjet e asnjë dokumenti.
 48. SHM-ja ka pranuar se, në pajtim me vendimin e prokurorit të EULEX-it për t'i pezulluar hetimet në lëndën PPS 26/2010, nga prokurori i EULEX-it ishin ndërmarrë veprime hetimore shtesë. Posaçërisht me 4 prill 2012 ishte dërguar një Autorizim tek Drejtoria e Policisë së Kosovës kundër Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në mënyrë që të vërtetoheshin faktet shtesë. Kjo ka rezultuar me një raport, i cili ka përmbajtur një numër të gjetjeve të bëra nga Policia e Kosovës. Më tej, prokurori i EULEX-it ka kërkuar nga Administrata Tatimore e Kosovës që t'i sigurojë atij një raport për "MTI Stone and Building Ltd". Ky raport i ishte ofruar prokurorit të EULEX-it me 5 qershor 2012. Me 3 korrik 2012, prokurori i EULEX-it e kishte intervistuar një të punësuar të kompanisë në cilësinë e dëshmitarit.
 49. Më tej SHM-ja ka theksuar se hetimet rreth lëndës PPS 26/2010 kishin mbetur të pezulluara në atë kohë dhe se nuk ishte marrë vendimi për rifillimin e tyre.
 50. Ankuesi ka pohuar se lënda nr. PPS 26/2010 dhe lënda nr. PP 360/2012 është dashur që të shqyrtohen së bashku pasi që subjektet e tyre ishin të lidhur ngushtë me njëra tjetrën. Ankuesi si palë e dëmtuar dhe avokati i tij ishte dashur që të ftoheshin të merrnin pjesë gjatë marrjes në pyetje të të pandehurve nga ana e policisë dhe prokurorit të EULEX-it. Më tej është thënë se në këtë rast ishin caktuar një numër i prokurorëve të ndryshëm çka e ka penguar progresin e arsyeshëm të hetimeve. Këto veprime të prokurorëve të EULEX-it ishin "veprime politike" dhe nuk kishin kurrfarë baze ligjore.
 51. Për aq sa ka pohuar ankuesi se lëndët është dashur që të shqyrtoheshin së bashku, SHM-ja në parashtresat plotësuese të tij të datës 23 mars 2015 i është referuar bazës ligjore për krijimin e procedurave të përbashkëta të përcaktuara në Nenin 33 (6) dhe (7) dhe Nenin 305 (3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, (KPPK). Kushtet e përcaktuara në KPPK për bashkimin e lëndëve nuk janë plotësuar. Më tej është pranuar se Nenet 151-155 të KPPK e autorizojnë palën e dëmtuar apo përfaqësuesin e autorizuar të saj që të jetë i pranishëm gjatë shqyrtimit të pandehurit. Për aq sa ankesa kishte të bënte me numrin e prokurorëve të caktuar në këto raste, SHM-ja ka arsyetuar se përderisa mund të duket sikur numri i prokurorëve që merren me secilin rast mund të ketë pasoja negative në efikasitet, në realitet prokurori i EULEX-it i caktuar në lëndën nr. PPS 26/2010 ishte i familjarizuar me këtë lëndë që prej fillimit kurse caktimi i lëndës nr. PP360/2012 tek një prokuror tjetër nuk ka rezultuar në vonesa të mëtejme të hetimeve.

PRANUESHMËRIA

52. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullat 25 dhe 29 të Rregullores së vet të Punës.
53. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, ankesat mund të parashtrohen në Panel nga çdo person përveç personelit të misionit EULEX-i Kosovë, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së drejtave të njeriut nga EULEX-Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.
54. Paneli ka konstatuar në mënyrë të përsëritur më parë se veprimet e ndërmarra nga ndonjë prokuror i EULEX-it gjatë shqyrtimit të një lënde janë pjesë e mandatit ekzekutiv të misionit EULEX-i Kosovë dhe se këto veprime hyjnë brenda mandatit të Panelit deri kur dhe përfshirë ngritjen e aktakuzës në ndonjë gjykatë kompetente që është kompetente për t'i shqyrtuar meritat e një lënde (shih p.sh. *B.Y kundër EULEX-it*, 2014-06, par. 12, *I kundër EULEX-it*, 2013-01, 27 nëntor 2013, par. 12; *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, në par. 20-22; *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013 në par. 32; *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012 në par. 21; *Hoxha kundër EULEX-it*, 2011-18, 23 nëntor 2011 në par. 22; *S.M. kundër EULEX-it*, 2011-11, 23 nëntor 2011 në par.15, *Sadik Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, par. 64).
55. Paneli vlerëson se në rastin konkret veprimet ndaj të cilave është bërë ankesa kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me veprimet e prokurorëve të EULEX-it gjatë ushtrimit të funksioneve ekzekutive të tyre. Paneli e pranon se ankesa bën pjesë në kuadër të mandatit të tij dhe i plotëson kriteret e pranueshmërisë ashtu siç janë të përcaktuara në Rregulloren e tij të Punës. Më tej vlerësohet se mekanizmat gjyqësor në dispozicion në Kosovë i kanë ofruar përfundimisht kërkuesit korrigjimin me anë të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të nxjerrë në vitin 2015. Sidoqoftë, Paneli tashmë ka konstatuar se ky fakt i vetëm nuk e liron EULEX-in nga obligimet e veta lidhur me mbrojtjen efektive të drejtave të njeriut (shih *Becic kundër EULEX-it*, nr. 2013/03, 12 nëntor 2014, par. 59).

VLERËSIMI NGA PANELI

56. Për aq sa ankuesi ankohet në bazë të Nenit 13 të Konventës, Paneli tashmë ka pasur raste kur ka theksuar se misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se mundësia e tij për të garantuar mbrojtje efektive të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët nga një shtet (shih vendimin e Panelit në *A,B,C,D kundër EULEX-it* nr. 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, § 50; *K deri T kundër EULEX-it*, i cituar më sipër, par. 53; krahaso po ashtu vendimin e Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm PKDNj) në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35).
57. Prandaj pritshmëritë të cilat janë krijuar mbi mundësinë e EULEX-it Kosovë që t'i kryej hetimet dhe që t'i zgjidh lëndë e ndërlikuara penale duhet të jenë reale. Paneli nuk iu imponon autoriteteve hetimore të EULEX-it obligimin për të hetuar deri në atë masë që e tejkalon mandatin dhe burimet e tij (shih vendimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, më tej: PSHDNj; në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09,

- mutatis mutandis*). Prandaj, nga Paneli është kërkuar që të shqyrtojë nëse ekzistojnë pengesa konkrete dhe reale përpara tij të cilat mund t'i pengojnë kapacitetet e EULEX-it për të kryer hetime të shpejta dhe efektive. Ky vlerësim nuk ka për qëllim t'i arsyetojë mangësitë operacionale që nuk ndërlidhen me sfidat konkrete dhe të provueshme, por për të siguruar që nga EULEX-i të mos pritet të bëjë më shumë se sa atë që në mënyrë të arsyeshme ia mundëson ta bëjë mandati i tij.
58. Në këtë rast, Paneli fillimisht thekson se kërkesa për ta caktuar ndonjë gjyqtar të EULEX-it në këtë rast është bërë nga prokuroria me 25 nëntor 2010. Prokurori në kërkesën e tij e ka përmendur natyrën e rëndë të rastiit dhe për çka bëhej fjalë si rrethana që e arsyetojnë caktimin e një gjyqtari të EULEX-it për këtë rast (shih paragrafin 14 më sipër) dhe gjyqtari e ka pranuar këtë kërkesë. Andaj, nuk kontestohet se rasti ka qenë mjaft i rëndë që të merrej përsipër nga EULEX-i, veprim ky që është i rezervuar për rastet penale më të rënda.
 59. Megjithatë, më tej theksohet se ankuesi e ka kontaktuar për herë të parë EULEX-in në shtator 2009. Pasi i ka plotësuar parashtresat e tij me 11 mars 2010, lënda nr. PPS 36/2010 ishte bartur në Prokurorinë e Qarkut në Mitrovicë pas dy muajsh. Më pas kjo i ishte caktuar prokurorit të EULEX-it P.K. me 10 nëntor 2010. Nga shefi i Misionit nuk është treguar apo argumentuar nëse është ndërmarrë ndonjë veprim hetimor për këtë rast përpara kësaj date. Po ashtu, për këtë nuk është dhënë asnjë sqarim.
 60. Më pastaj rasti i është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it me 17 janar 2011 kurse hetimet përfundimisht kishin filluar më 23 shkurt 2011, një vit e katër muaj pasi ankuesi kishte kontaktuar për herë të parë me EULEX-in. Paneli vërteton se një urdhër për bastisjen e shtëpisë ishte nxjerrë shumë shpejtë pas kësaj dhe se kjo bastisje ishte kryer me shpejtësi, në mars 2010. Megjithatë, nuk është ofruar asnjë dëshmi se ish-in ndërmarrë veprime të tjera hetimore më pas, deri sa ishte nxjerrë vendimi për pezullimin e procedurave me 4 gusht 2011, dhe kjo përkundër një autorizimi të datës 30 mars 2011, që i obligonte hetuesit që të zhvillonin disa veprime hetimore.
 61. Më tej theksohet se disa veprime hetimore ish-in ndërmarrë ndërmjet datës 4 gusht 2011, kur rasti ishte pezulluar formalisht, dhe datës 17 nëntor 2014, kur formalisht ai kishte rifilluar. Do të thotë se është dëgjuar një dëshmitar, një raport i inspektimit tatimor është paraqitur nga autoritetet kosovare, ndërsa Policia e Kosovës ishte ngarkuar që t'i kryente disa veprime të caktuara hetimore (shih par. 20-23 më sipër). Panelit nuk i është dhënë asnjë sqarim lidhur me bazat ligjore në pajtim me të cilat ish-in ndërmarrë këto veprime ndërsa lënda formalisht ishte e pezulluar.
 62. Hetimet kanë rifilluar me 14 dhjetor 2014. Me sa duket sot e kësaj dite ato janë ende të pakryera. Panelit nuk i është bërë asnjë parashtresë për t'i treguar se cilat veprime hetimore, nëse ka pasë të tilla, janë zbatuar që nga atëherë; apo për arsyet rreth të cilave nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim deri sa ishte bërë korrigjimi i situatës së ankuesit në qershor 2015 përmes aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike.
 63. Më tej theksohet se këto hetime ish-in pezulluar po ashtu në bazë të asaj se të dyshuarit nuk pritej se do t'i nënshtroheshin juridiksionit të autoriteteve të Kosovës. Ato kanë rifilluar me 13 dhe 14 shkurt 2014

kurse urdhër arrestet ndaj të dyshuarve ishin tërhequr të nesërmen me kërkesë të prokurorit të EULEX-it. Paneli vlerëson se duke i ditur vështirësitë e mëparshme për t'i sjellë të dyshuarit përpara drejtësisë, siç thuhet në vendimin për pezullimin e procedurave, vendimi për t'i tërhequr urdhër arrestet dhe vendimi për ta bërë këtë përpara ndonjë përpjekje të dëshmuar për t'i marrë në pyetje të dyshuarit lë vend për t'u kritikuar.

64. Paneli vëren se as ankuesi e as avokati i tij nuk ishin ftuar që të merrnin pjesë gjatë marrjes në pyetje të dy të dyshuarve kur ata ishin intervistuar në kontekstin e hetimeve të dyta (PP 360/2012) në dy raste gjatë muajit shkurt 2013, përkundër faktit se ligji i zbatueshëm shprehimisht e lejon këtë mundësi. Panelit nuk i është sqaruar nëse ankuesi ose avokati i tij ishin informuar për këto intervista apo jo dhe nëse jo për çfarë arsye. Panelit nuk i është paraqitur asnjë argument për të sqaruar se pse nuk është marrë apo nuk është paraparë ndonjë vendim për t'i intervistuar ata në kontekstin e hetimeve të para derisa dy të dyshuarit në atë kohë ishin në Kosovë dhe në dispozicion për t'u intervistuar.
65. Duke i pasur parasysh rrethanat e këtij rasti në tërësi, Paneli gjen se ka pasur shkelje të së drejtës së ankuesit për zgjidhje efektive e garantuar me nenin 13 të Konventës.
66. Duke i pasur parasysh gjetjet e tij sipas nenit 13, Paneli konsideron se nuk është e domosdoshme që kjo ankesë të shqyrtohet sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës (për qasje të ngjashme shih *Becic kundër EULEX-it*, cituar më lartë, par. 62).

PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJËZËRI,

1. **Konstaton** se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.
2. **Konstaton** se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës;
2. **Gjen të përshtatshme**, duke i marrë parasysh gjetjet e mësipërme të tij të fakteve dhe ligjin, që t'i bëjë rekomandimet vijuese për SHM-në sipas Rregullës 34 të Rregullores së tij të Punës:
 - a. Që SHM-ja ta bëjë një deklaratë se e pranon që rrethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit, që i ngarkohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-it Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të tij;
 - b. Që SHM-ja duhet t'ju ofrojë për informim kopjen e këtij Vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese